

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm**, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Igballe Azemi, në lëndën penale kundër të pandehurit Sh. H nga fsh., për shkak të veprave penale Kanosje nga neni 185 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 dhe Sulmi nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-s, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.706/2015, të datës 13.05.2015 të cilën e përfaqësonte Prokurori Esat Ademi, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 25.05.2016, mori dhe publikisht shpalli këtë,

### A K T G J Y K I M

I pandehuri **Sh. H**, nga babai Q, e ëma E, e lindur M, i lindur ..në Gj, me banim në fshatin.., ka të kryer shkollën e mesme, veteran i luftës - penzioner, i martuar-baba i 3 fëmijëve, i gjendjes ekonomike të mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

### Ë s h t ë f a j t o r

Sepse më datë 01.05.2016, rreth orës 10.30 minuta, në Gjilan, në rrugën..., në një arë mbrapa Motelit "...", me qëllim të frikësimit ose të shkaktimit të ankthit, për shkak të një kontesti pronësor, me fjalë dhe veprime e ka kanosur seriozisht të dëmtuarin R. R nga Gj, në atë mënyrë që në fillim të njëjtit i drejtohet me fjalët " Kush jeni ju, pse keni hy në arën time, dil prej saj dhe mos të shoh më kurrë, ta q.. nënën , të bëj pleh more bërlllog " dhe më pastaj shkon te vetura e merr një kaçavide dhe niset në drejtim të dëmtuarit, por me atë rast i del përpara kushëriri i të dëmtuarit R. V dhe e kap për dore e me këtë edhe e ndal të njëjtin, mirëpo me këto veprime i pandehuri te i dëmtuari kishte shkaktuar ankth dhe frikë sepse i njëjti kishte disa kohë që me familjen e tij ishte në një kontest pronësor juridik për këtë arë.

me çka ka kryer veprën penale kanosja nga neni 185 par. 4 lidhur me par.2 të KPRK-s. Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 45. 46, 47, 73 dhe 75 të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarin,

### E G J Y K O N

Të akuzuarit **Sh. H**, për veprën penale nga dispozitivi **I** i këtij aktgjykimi, i shqiptohet dënim me burg në kohëzgjatje prej nëntëdhjetë (90) ditë, i cili dënim do të ekzekutohet, kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, dhe për veprën penale nga dispozitivi **II**. i këtij aktgjykimi, i shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro, të cilin dënim i akuzuari do t'a paguaj në afat prej 30 ditë nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

**II.** Në bazë të nenit 47 të KPRK-s, dënimi me burg në kohëzgjatje prej 90 ditë me pëlqimin e të pandehurit Sh. H i **ZËVENDËSOHET** me dënim me gjobë në shumë prej 900 (nëntëqindë) €, të cilën do ta paguaj në afatë prej 15 ditësh.

**III.** Nëse i akuzuari refuzon që të paguajnë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguajë atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

**V.** Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 30 (tridhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbarrimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit Sh. H nga fsh., për shkak të veprave penale Kanosje nga neni 185 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 dhe Sulmi nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-s.

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, të mbajtur më datën 25.05.2016, Prokurori e Shtetit, Esat Ademi, ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës së paraqitur, duke i propozuar gjykatës të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit.

I dëmtuari R.R deklaron: i bashkangjitem ndjekjes penale të prokurorit të shtetit ndërsa nuk paraqesë kërkesë pasurore-juridike, kërkoj që i njëjti mos të na pengojë në pasurinë tonë. I dëmtuari A. R deklaron: i bashkangjitem ndjekjes penale të prokurorit të shtetit ndërsa nuk paraqesë kërkesë pasurore-juridik, por pasi që nuk është hera e parë që i njëjti më është kanosur kërkoj nga gjykata që të ndërmerren masa më rigoroze dhe që mos të përsëriten ma këto kërcnime.

I pandehuri Sh. H, deklaron: e ndijë veten fajtor dhe jam penduar thellë për këto vepra që i kam kryer dhe i kërkoj falje të dëmtuarve, më parë nuk kam kryer vepra penale dhe i premttoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale ndaj të dëmtuarve por as ndaj të tjerëve dhe e lus gjykatën që të ma shqiptoj një dënim sa më të butë.

Në fillim të shqyrtimit fillestar pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit, i akuzuari Sh. H ka deklaruar e pranorë fajësinë për kryerjen e veprave penale të cilat më vihen në barrë sipas kësaj aktakuze.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas dëgjimit të prokurorit dhe të dëmtuarve, konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajësisë, ngase i akuzuari e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari; se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike nga neni 253 të KPP.

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike :

Se i akuzuari, ka kryer veprat penale Kanosje nga neni 185 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 dhe Sulmi nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-s në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e shpalli fajtor të akuzuarin i, për shkak të kryerjes së veprat penale Kanosje nga neni 185 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 dhe Sulmi nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-s, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe përgjegjës penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 73 të KPRK, ku si rrethana lehtësuese, gjykata e ka marrë për bazë faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë; ju ka përgjigjur ftesave, sjelljen korrekte në gjykatë, se është penduar për kryerjen e kësaj vepre penale, ju ka kërkuar falje të dëmtuarve, më parë nuk ka kryer vepra penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, ndërsa rrethana rënduese dashjen për kryerjen e veprave penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, caktimi i dënimit me burg dhe me gjobë, ndaj të akuzuarit, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprave penale dhe shkallën e

përgjegjësisë së të akuzuarit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 41 të KP, i cili konsiston në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij.

Në kuptim të nenit 368 të KPP palët janë udhëzuar për të drejtën në ankesë.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 paragrafi 1-3 të KPP.

Për arsyet e lartcekura u vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr. 472/2015, Më 25.05.2016**

**Sekretarja juridike,**  
Igballe Azemi d.v

**Gjyqtari**  
Behar Ymeri d.v

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.